



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 21 tetor miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë që deklaratat e pesë dëshmitarëve të pranoheshin vetëm si prova me shkrim. Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën në lidhje me një dëshmitar të gjashtë, me qëllim që të mos shkaktohet dëm i papërligjur dhe të sigurohet që Mbrojtja të ketë mundësi të verifikojë mbështetshmërinë në deklaratën e dëshmitarit. Prokuroria mund të kërkojë që ky dëshmitar të japë dëshmi në gjykatë, ose të dorëzojë deklaratën me shkrim të dëshmitarit dhe ta vërë atë në dispozicion për pyetje nga Mbrojtja.

Më 18 tetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për urdhërimin e masave mbrojtëse për një numër dëshmitarësh, si edhe miratoi dhënien e dëshmisë përmes videokonferencës nga disa dëshmitarë të tjerë.

Gjatë kësaj jave, në këtë gjykim dhanë dëshmi në sallë të gjyqit dy dëshmitarë. Fadil Geci dha dëshmi kryesisht pa masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes së dhënë nga Prokuroria, Fadil Geci ishte anëtar i UÇK-së dhe mbajti pozita të ndryshme në LDK gjatë kohës në fjalë. Edhe dëshmitari i dytë, Nuredin Ibishi, dëshmoi në seancë të hapur. Sipas Prokurorisë, ai mbajti një numër pozitash në UÇK, në Zonën Operative të Llapit, përfshirë edhe postin e komandantit të brigadës dhe atë të shefit të shtabit. Z. Ibishi është dëshmitari i nëntëdhjeteshtatë që dëshmon në këtë çështje gjyqësore.

Seanca tjetër në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 28 tetor, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, Paneli i Gjykatës Kushtetuese miratoi një kërkesë të Prokurorisë dhe të Mbrojtës së Viktimave për të dorëzuar parashtrime në përgjigje të kërkesës referuese që z. Mustafa i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese më 27 shtator. Në kërkesën referuese z. Mustafa pretendon, ndër të tjera, se iu shkelën të drejtat e tij kushtetuese kur Gjykata Supreme lejoi Mbrojtësen e Viktimave të bënte parashtrime në lidhje me kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kur Gjykata Supreme vendosi se Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i vitit 1976 nuk mund të merrej për bazë në përcaktimin e shkallëzimit të dënimit.

Paneli i Gjykatës Kushtetuese theksoi se nuk ekziston e drejtë e vetvetishme për parashtrime në përgjigje të kërkesave referuese që i paraqiten Gjykatës Kushtetuese, për arsye se në Gjykatë Kushtetuese procesi nuk është i llojit ballafaques sepse ka të bëjë me shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut të një personi. Megjithatë, Paneli e gjykoji të përshtatshme që, në rrethanat aktuale dhe si rast i veçantë, të pranojë parashtrime nga këta dy pjesëmarrës në procesin penal fillestar. Gjykata Kushtetuese u caktoi si afat 8





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**  
Nr. 40/2024  
Hagë, 24/10/2024

nëntorin. Në qoftë se z. Mustafa dëshiron t'u përgjigjet parashtimeve, ai urdhërohet t'i dorëzojë ato deri më 29 nëntor 2024.

